



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1331/15 prot.

Tiranë, më 28.02.2024

**N J O F T I M**

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”, Statutit të TKOBAP të miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin për pozicionin e punës Koncert Maestër (Pianist) pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Për t'i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t'i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve, TKOBAP nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme.

Audicioni do të zhvillohet në **datën 26.03.2024, ora 11:00, në Hollin Koncertor** të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

**-Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:**

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje të certifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

**Të gjithë artistët e interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP-së deri në datën 19.03.2024, ora 16:30:**

1. Një letër shprehje interesi për vendin vakant;
2. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;

3. Vërtetim të gjendjes shëndetësore ose një dokument ekuivalent me të;
4. Vërtetim të gjendjes gjyqësore ose një dokument ekuivalent me të;
5. Fotokopje të diplomës dhe listë notash të noterizuar në shtetin përkatës (të ketë kryer studimet e larta në nivelin Master për piano brenda ose jashtë vendit);
6. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
7. Jetëshkrim (Curriculum Vitae) bashkëngjitur me foto dhe dokumentacionin e nevojshëm që vërteton: veprimtarinë ndër vite të certifikuar, Master class-e, Work shop-e, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, tituj artistikë si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën e tij artistike për vendin vakant për të cilin aplikon.
8. Dokumentet që vërtetojnë njohurinë minimalisht të 2 gjuhëve të huaja, të detyrueshme anglisht dhe italisht.

### **Programi:**

#### **\*Programi për konkurimin është interpretimi i roleve të plota (përzgjedhja e roleve për interpretimin nga kandidatët do të bëhet Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:**

- |             |  |
|-------------|--|
| G. Puccini  | Madama Butterfly – Akti 1 nga “Viene la sera” (n. 116) deri ne fund te aktit<br>Madama Butterfly – Skena e letrës (Akti 2, n. 41 deri tek n. 60) |
| G. Puccini  | Tosca – Dueti Mario, Mario, Mario...son qui! (Akti 1, tri masa para n. 25)<br>Tosca – “Ov’è Angelotti” (Akti 2, n. 19 deri tek n. 51)            |
| P. Mascagni | Cavalleria Rusticana – “Il cavallo scalpita”, “Inneggiamo”, “Voi lo sapete o mamma”  |
| G. Verdi    | Aida – Gran finale secondo   |
| G. Verdi    | Attila – Akti i tretë komplet  |

Një koncert për piano dhe orkestër, sipas dëshirës së kandidatit/es.

### **Shënim:**

#### **-Komisioni ruan të drejtën:**

1. Të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit
2. Të kërkojë këndimin e parteve solistike të veprave të përcaktuara si më lart.

3. Të kërkojë shpjegimin e kuptimit të teksteve të kënduara nga çdo personazh dhe t'i kërkojë kandidatit që të flasë për kompozitorët dhe veprat që janë program i audicionit.

4. Të kërkojë simulimin e një ore prove me një këngëtar, relative e veprave të kërkuara në program.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën elektronike: [sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al).

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Abigeila Voshtina**

